

SYLLABUS

Lënda: NUDE II. Viti -IV (Semestri: VII - VIII)

Prof. Majlinda Kelmendi

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Arteve Programi i studimit - Arte Vizuale (BA) – Pikturë, Skulpturë, Grafikë, Ilustrim dhe Vizatim,
Titulli i lëndës:	Qasje bashkëkohore për vizatimin e jetës.
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti -IV (Semestri: VII - VIII)
Numri i orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	3+3 Sim I, Sim II - 6 ECTS
Koha / lokacioni:	E Martë 12:30-14:45 Fakulteti Arteve të Bukura, Universiteti Prishtinës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Majlinda Kelmendi
Detajet kontaktuese:	Email: majlinda.kelmendi@uni-pr.edu Tel: +37744-146-036
Përshkrimi i lëndës	Lënda Nude II, synon që studentët të eksplorojnë përmes metodave bashkëkohore dhe të zhvillojnë një studim të thellë, aftëson studentët për procese punuese në mënyrë të pavarur duke u angazhuar ata për portfolio dhe përgatitje për prezantim. Gjatë këtij kursi bëhen studime intensive duke përfshirë teknikat dhe parimet e kurseve të mëparshme me theks në koncepte dhe përsoshmëri artistike. Duke integruar eksperimenti në kompozim, formë, levizje, teknika si dhe koncepteve filozofike. Studentët angazhohen në seri të gjerë teknikash dhe teorish për të pasuruar dhe zgjeruar aftësitë e tyre artistike. Krijimi i punimeve artistike në mënyrë kreative duke e lidhur me imagjinatën dhe vendosjen e figurës njeriut në shërbim të idese dhe mesazhit që secili student ka për qëllim të sjellë në punimin që realizon.
Qëllimet e lëndës:	Lënda Nude II synon të përqendrohet në zhvillimin e aftësive të avancuara, aftësimi i studentëve për pjesëmarrje të pavarur në promovime, duke eksploruar teknika dhe interpretimi bashkëkohor. Në këtë kurs, studenti do të thellojë kuptimin mbi kompozimin. Përmes një kombinimi të analizës së praktikave historike dhe eksperimentet me qasje bashkëkohore, ky kurs i jep studentit lirinë për të eksploruar shprehjen artistike dhe për të zhvilluar një stil të pavarur artistik.

Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit, studenti pritet të:</p> <p>1-Demonstrojë aftësi të avancuara në vizatimin e figurës njerëzore, duke përdorur teknika të ndryshme dhe duke përfaqësuar një qasje bashkëkohore.</p> <p>2-Përdorë elementët e kompozimit, linjës, dritës dhe hijes për të përfaqësuar emocionet, lëvizjet dhe volumin e figurës me saktësi dhe kreativitet.</p> <p>3-Tregojë një kuptim të thelluar të formës dhe proporcioneve të trupit njerëzor, duke përfshirë interpretime eksperimentale.</p> <p>4-Reflektojë mbi procesin e tij artistik dhe të analizojë ndikimin e zgjedhjeve të tij teknike dhe stilistike në përçimin e mesazhit në teknika dhe media të ndryshme.</p> <p>5-Krijojë një stil personal, i cili pasqyron aftësitë dhe qasjen e tij unike ndaj figurës.</p>
---	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	30 javë	90
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike	1	30 javë	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare			
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	6	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	4	4
Totali	3 orë	30 javë	150 orë

<p>Metodologjia e mësimëdhënies:</p>	<p>Kursi përdor një qasje të ndërthurur midis ligjëratave teorike, demonstrimeve praktike dhe punës individuale në studio për të zhvilluar aftësi të avancuara në vizatimin e figurës. Ligjëratat dhe demonstrimet do të përqendrohen në teknika të ndryshme bashkëkohore, ndërsa sesionet e punës praktike do t'i japin studentit mundësinë për të eksploruar interpretimin në mënyrë të pavarur. Diskutimi dhe analizat në grup do të inkurajojnë shkëmbimin e ideve dhe do të ndihmojnë studentët të reflektojnë mbi procesin e tyre artistik. Studentit do t'i jepen ushtrime të ndryshme, për të përmirësuar teknikën dhe interpretimi në lëvizje dhe formë. Kjo metodologji mbështet studentin në zhvillimin e shkathtësive teknike dhe krijimin e një perspektive unike artistike përmes një kombinimi të mësimiit teorik dhe praktik</p>
<p>Metodat e vlerësimit:</p>	<p>Vlerësimi për këtë kurs bazohet në një sistem pikësh që mat angazhimin, performancën dhe rezultatet e studentëve gjatë semestrit. Totali maksimal i pikëve është 100, të ndara si më poshtë:</p> <p>Komponentët e Vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Pjesëmarrja aktive dhe vijimi i rregullt – 10 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Vlerësohet përmes pranishmërisë së rregullt në orë dhe angazhimit aktiv në diskutime. 2. Provimi i semestrit I – 25 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Përfshin temat e trajtuara gjatë semestrit të parë dhe projektet praktike dhe me shkrim të zhvilluara. 3. Provimi i semestrit II – 25 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Përfshin temat e trajtuara gjatë semestrit të dytë dhe projektet praktike të zhvilluara. 4. Provimi përfundimtar – 40 pikë <ul style="list-style-type: none"> ○ Prezantimi i një projekti përmbledhës. Ky projekt vlerëson njohuritë dhe kreativitetin e studentit dhe projektet praktike të zhvilluara. <p>Sistemi i Notimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 91% – 100% e pikëve totale: Nota 10 (shkëlqyeshëm) • 81% – 90% e pikëve totale: Nota 9 (shumë mirë) • 71% – 80% e pikëve totale: Nota 8 (mirë) • 61% – 70% e pikëve totale: Nota 7 (mjaftueshëm) • 51% – 60% e pikëve totale: Nota 6 (kalues) • < 51% e pikëve totale: Nota 5 (nuk kalon)

Literatura	
Literatura bazë:	<p>"Drawing from Life" nga Clint Brown dhe Cheryl McLean Një udhëzues gjithëpërfshirës për teknikat, duke përfshirë metoda tradicionale dhe bashkëkohore.</p> <p>"The Artist's Complete Guide to Figure Drawing" nga Anthony Ryder Ky libër ofron një qasje të hollësishme duke theksuar vëzhgimin e detajuar dhe teknikat realiste.</p> <p>"Figure Drawing: Design and Invention" nga Michael Hampton Një manual praktik që përqendrohet në krijimin e formave dinamike dhe dizajnin e figurës njerëzore.</p> <p>"Anatomy for Sculptors: Understanding the Human Figure" nga Uldis Zarins me Sandis Kondrats Një burim vizual për të kuptuar anatoninë e figurës, shumë i dobishëm për artistët.</p> <p>"The Natural Way to Draw: A Working Plan for Art Study" nga Kimon Nicolaïdes Një libër klasik që ofron një plan të strukturuar për të mësuar teknikat në mënyrë intuitive dhe natyrale.</p> <p>"Drawing on the Right Side of the Brain" nga Betty Edwards Një libër që përqendrohet në zhvillimin e aftësive vizuale dhe perceptuese për artistët e çdo niveli.</p> <p>"Contemporary Drawing: Key Concepts and Techniques" nga Margaret Davidson Një eksplorim i praktikave bashkëkohore të vizatimit, duke përfshirë teknikë, medime dhe qasje konceptuale.</p> <p>"Ways of Seeing" nga John Berger Një tekst klasik që sfidon mënyrën se si shohim dhe interpretojmë artin dhe botën përreth nesh.</p> <p>Artikuj dhe Ese: "The Body in Contemporary Art" nga Sally O'Reilly Një eksplorim i mënyrave se si trupi njerëzor është përdorur dhe interpretuar në artin bashkëkohor. "Postmodern Perspectives on Art and Life Drawing" nga James Elkins Një diskutim mbi ndikimet e postmodernizmit në praktikat</p>
Literatura shtesë:	<p>Burime Online dhe Platforma Digjitale: Proko.com Udhëzime dhe tutoriale video për figurën dhe anatoninë. Drawabox.com Kurse dhe ushtrime online për të përmirësuar aftësitë e vizatimit.</p>

Plani i dizejnuar i mësimi: Viti i katert(Semestri i shtate)	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Prezantimi i lëndës, syllabusit, objektivat dhe metodat e mësimdhënies.
Java e dytë:	Qasjet bashkëkohore dhe ndikimet kulturore. Eksplorimi i artistëve dhe teknikat e tyre.

Java e tretë:	Psikologjia: si ndikon perceptimi dhe ndjenjat në krijimin e artit.
Java e katërt:	Integrimi i teorisë së artit bashkëkohor dhe mediat e përziera. Shembuj të praktikave ndërdisiplinore.
Java e pestë:	Teknikat Eksperimentale: Eksperimentimi me teknikë dhe medime të ndryshme.
Java e gjashtë:	Teknikat Eksperimentale, diskutime mbi përdorimin e materialeve jo-tradicionalë.
Java e shtatë:	Teknikat Eksperimentale Analizë dhe kritika e teknikave eksperimentale në artin bashkëkohor.
Java e tetë:	Eksplorimi i temave si identiteti ne art. Studim rastesh dhe diskutime.
Java e nëntë:	Filozofia postmoderne dhe ndikimet e saj në art. Analizë e veprave të artistëve të njohur.
Java e dhjetë:	Projekt i klasës: zhvillimi i veprës që eksploron një temë konceptuale.
Java e njëmbëdhjetë:	Ndikimi i kulturës dhe historisë në veprën artistike. Studio shembuj të artit nga kultura të ndryshme.
Java e dymbëdhjetë:	Zhvillim i projektit për secilin student..
Java e trembëdhjetë:	Realizimi punimitne klase, Konsulta dhe diskutime me secilin student pergatitja e punimit me shkrim..
Java e katërbëdhjetë:	Studim, realizim i punimit, korrekture.
Java e pesëmbëdhjetë:	Analizë dhe kritikë individuale dhe grupore te punes Prezantimi me shkrim i punës semestrale.Vleresimi me pike.

Plani i dizajnuar i mësimi: Viti i katert (Semestri i tete)	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e gjashtëmbëdhjetë:	Ndërthurja dhe përdorimi i teknologjive digjitale në punimin semestral.
Java e shtatëmbëdhjetë:	Diskutimi dhe analiza e ndikimeve të teknologjisë në estetikën dhe procesi krijues.
Java e tetëmbëdhjetë:	Bashkëpunimi në projekte artistike. Rëndësia e punës në grup dhe ndarja e ideve.
Java e nëntëmbëdhjetë:	Krijimi i një projekti bashkëpunues: planifikimi dhe realizimi i veprës.
Java e njëzetë:	Prezantimi dhe kritika e projekteve bashkëpunuese.
Java e njëzetë e një:	Përshtatja e metodave të ndryshme në përshtatje te qëllimit dhe idesë. Ligjëratë: "Rëndësia e skicave dhe shënimeve në punën e mëtutjeshme për artin bashkëkohor.
Java e njëzetë e dy:	Integrimi i platformave online në procesin mësimor.
Java e njëzet e tre:	Krijimi dhe implementimi i I teknologjise ne praktike .
Java e njëzetë e katër:	Planifikimi dhe zhvillimi i një projekti individual duke aplikuar teknikat e mësuara.

Java e njëzetë e pesë:	Konsultime dhe mbështetje për projektet individuale.
Java e njëzet e gjashtë:	Realizimi i kompozimit nga imagjinata duke dhene nje teme te caktuar (pasqyrimi i i aftesise imaginative dhe qasja personale e studentit ne teknike te caktuar)
Java e njëzet e shtatë:	Prezantimi dhe diskutimi i projekteve individuale. Ligjëratë: “Rëndësia e skicave dhe shënimeve në punën e mëtutjeshme
Java e njëzetë e tetë:	Raportet vizuale- teknike në punimin gjat Ligjëratë: “Rëndësia e skicave dhe shënimeve në punën e mëtutjeshme zhvillimit artistik.
Java e njëzet e nëntë:	Analizë dhe kritikë individuale dhe grupore Prezantimi me shkrim i punës semestrale
Java tridhjetë:	Vleresimi

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Arrdhja 15 minuta për përgatitje para orarit të përcaktuar të mësimit.

Fikja e telefonave celularë

Zbatimi me korrektesi i orarit të mbarimit të mesimit

- **Për kredi të plotë, duhet të ruani të gjithë punën tuaj deri në fund të semestrit.**
- **Të gjitha projektet duhet të etiketohen me emrin tuaj, datën e përfunduar dhe titullin e detyrës.**

Përgatitur: Prof. Majlinda Kelmendi

Prishtinë, 22.07.2024